



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI**

VENDIM

Nr. 136, datë 31.10.2014

PËR

**DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË RREGULLOREN NR. 131, DATË 06.10.2011,
“MBI KODIN E SJELLJES SË SHOQËRISË ADMINISTRUESE TË SIPËRMARRJEVE
TË INVESTIMEVE KOLEKTIVE”**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pikës 2, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, të ndryshuar, nenit 128 të Kodit të Procedurës Administrative, me propozim të Departamentit të Licencimit dhe Monitorimit, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

1. Miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në Rregulloren nr. 131, datë 06.10.2011, “Mbi kodin e sjelljes së shoqërisë administruese të sipërmarrjeve të investimeve kolektive”, sipas materialit bashkëlidhur.
2. Ngarkohen departamentet përkatëse për njoftimet në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Enkeleda SHEHI

Në Rregulloren nr. 131, datë 06.10.2011, “Mbi kodin e sjelljes së shoqërisë administruese të sipërmarrjeve të investimeve kolektive” bëhen ndryshimet si më poshtë:

1. Në fillim të rregullores shtohet togfjalëshi **“Kreu I të përgjithshme”**;

2. Neni 1, objekti, ndryshon si më poshtë:

“Objekt i kësaj rregulloreje është përcaktimi i rregullave të sjelljes së shoqërisë administruese të sipërmarrjeve të investimeve kolektive në lidhje me informimin e investitorëve, transparencën në informim, njohjen e profilit të investitorit, si dhe rregullave organizative, teknike, të sigurisë dhe cilësisë së personelit, me qëllim garantimin e kryerjes me efektivitet të veprimtarisë të sipërmarrjeve të investimeve kolektive.”;

3. Pas nenit 2, shtohet, **“Kreu II njohja e investitorit dhe transparenca në informimin e tij”** si dhe nenet 3, 4, 5 dhe 6 me këtë përmbajtje:

“Neni 3 Njohja e investitorit

1. Shoqëria administruese e sipërmarrjes së investimeve kolektive harton dhe zbaton procedura për identifikimin, për çdo sipërmarrje të investimeve që ka nën administrim, të numrit të investitorëve, profilit të investitorit që nënkupton nevojat dhe sjelljen e tij ndaj investimit dhe riskut, madhësinë e zotërimeve të secilit prej investitorëve, me qëllim parashikimin sa më saktë të efektit të shlyerjes së njëkohshme të kuotave nga disa investitorë. Për këtë qëllim shoqëria administruese merr në konsideratë të paktën faktorët e mëposhtëm:

- a) modele apo shembuj që identifikojnë nevojat e investitorëve për para (cash);**
- b) natyrën dhe shkallën e kompleksitetit të investitorëve të ndryshëm;**
- c) shkallën e risku që mund të ndërmarrin investitorë të ndryshëm;**
- d) shkallën e korrelacionit apo të lidhjeve të ngushta mes investitorëve të ndryshëm të një sipërmarrje të investimeve kolektive.**

Neni 4 Monitorimi i likuiditetit

1. Shoqëria administruese e sipërmarrjes së investimeve kolektive harton dhe zbaton procedura nëpërmjet të cilave arrin të sigurohet se:

- a) vlera e kuotave ose aksioneve të mbajtura nga një investitor i vetëm, në çdo kohë, të mos kalojë vlerën e aseteve ditore që maturohen;**
- b) shlyerja e kuotave nga një investitor nuk ndikon materialisht profilin e likuiditetit të sipërmarrjes së investimeve kolektive.**

Neni 5 Transparenca

2. Çdo dokument i sipërmarrjes së investimeve kolektive i përdorur për qëllime marketingu duhet të përfshijë në mënyrë të qartë deklaratat si më poshtë:

- a) Investimi në sipërmarrjen e investimeve kolektive nuk është një investim i garantuar;**
- b) Sipërmarrja e investimeve kolektive nuk bazohet në përkrahjen e ndonjë subjekti jashtë tij për garantimin e likuiditetit apo stabilitetit të vlerës neto të aseteve;**
- c) Rreziku i humbjes së principalit duhet të përballohet nga investitori;**
- d) Kuotat/aksionet e sipërmarrjes së investimeve kolektive nuk janë të siguruara nga skema e sigurimit të depozitave.**

3. Shoqëria administruese e sipërmarrjes së investimeve kolektive harton dhe zbaton procedura ku përcaktohet detyrimi që çdo punonjës apo agjent shitës i kuotave/aksioneve të

sipërmarrjes së investimeve kolektive në mënyrë të qartë dhe jo çorientuese i ka komunikuar çdo investitori apo investitori potencial se:

- a) investimet në sipërmarrjen e investimeve kolektive nuk janë të garantuara apo të siguruara nga skema e sigurimit të depozitave;
- b) investimi në kuota apo aksione të sipërmarrjes së investimeve kolektive nuk është i garantuar.

4. Investitorët në një sipërmarrje të investimeve kolektive duhet të informohen në mënyrë të qartë për metodën apo metodat e përdorura nga ana e shoqërisë administruese për vlerësimin e aseteve të fondit të investimeve dhe llogaritjen e vlerës neto të aseteve (NAV).

Neni 6

Etika në informimin e investitorëve

1. Shoqëria administruese e sipërmarrjes së investimeve kolektive harton dhe zbaton procedura nëpërmjet të cilave siguron se i gjithë informacioni, duke përfshirë komunikimet marketing, për investitorët apo klientët potenciale është i drejtë, i qartë dhe jo çorientues. Komunikimet e marketingut duhet të identifikohen qartë si të tilla dhe të dallojnë nga informacionet e tjera.
2. Shoqëria administruese e sipërmarrjes së investimeve kolektive jep në një formë të kuptueshme për investitorët apo klientët potencialë, informacionin e duhur në lidhje me:
 - a) sipërmarrjen e investimeve kolektive;
 - b) instrumentet financiare dhe strategjitë e propozuara të investimeve, duke përfshirë udhëzime të përshtatshme për paralajmërimet e rreziqeve që lidhen me investimet në këto instrumente ose në lidhje me strategjitë e veçanta të investimeve;
 - c) vendin e kryerjes së transaksioneve; si dhe
 - d) kostot dhe pagesat në mënyrë që investitorët të jenë në gjendje të kuptojnë natyrën dhe rreziqet e investimit, si dhe natyrën e veçantë të instrumentit financiar që po u ofrohet për të marrë vendime për investime mbi bazën e një informimi të plotë.
3. Shoqëria administruese e sipërmarrjes së investimeve kolektive harton dhe zbaton procedura për mënyrën e këshillimit të investitorit, duke patur parasysh marrjen e informacionit të nevojshëm në lidhje me:
 - a) njohuritë dhe përvojën në fushën e investimeve që ka investitori apo klienti potencial në lidhje me produkte apo shërbime specifike;
 - b) gjendjen financiare dhe objektivat e investimit që ka investitori apo klienti potencial.Marrja e informacionit të mësipërm i jep mundësinë shoqërisë administruese t'i rekomandojë investitorit apo klientit potencial shërbime dhe instrumenta financiare që janë të përshtatshme për të.
4. Shoqëria administruese e sipërmarrjes së investimeve kolektive, kur ofron shërbime investimi të tjera përveç atyre të përmendura në paragrafin 3 të këtij neni, duhet të kërkojë nga investitori apo klienti potencial informacion në lidhje me njohuritë dhe përvojën e tij në fushën e investimeve që kanë të bëjnë me produktin specifik apo shërbimin e ofruar apo e kërkuar në mënyrë që shoqëria administruese të jetë në gjendje të vlerësojë nëse shërbimi apo produkti financiar është i përshtatshëm për klientin.
5. Në rast se, në bazë të informacionit të marrë sipas paragrafit të mësipërm, shoqëria administruese konsideron, se produkti apo shërbimi nuk është i përshtatshëm për investitorin apo klientin potencial, duhet ta paralajmërojë atë për rreziqet e ardhshme.

6. Në rastet kur investitori apo klienti potencial zgjedh të mos japë informacionin e referuar në këtë nen, ose jep informacion të pamjaftueshëm në lidhje me njohuritë dhe përvojën e tij, shoqëria administruese duhet të paralajmërojë investitorin apo klientin potencial se ajo nuk mund të japë këshilla nëse shërbimi apo produkti i parashikuar është i përshtatshëm apo jo për investitorin apo klientin potencial.

6. Pas nenit 6, shtohet togfjalëshi “**Kreu III rregulla organizative, teknike, të sigurisë dhe cilësisë së personelit**”;
7. Në nenin 12, Punonjësit dhe personat përgjegjës, në paragrafin 2, pas fjalëve “...referuar në nenin...” shtohet numrat “**98 dhe 99**”;
8. Në nenin 12, Punonjësit dhe personat përgjegjës, në paragrafin 3, pas fjalëve “...referuar në nenin...” shtohet numrat “**98 dhe 99**”;
9. Titulli i nenit 13 bëhet “**Kontrolli i brendshëm**”;
10. Në nenin 13, Kontrolli i brendshëm, në paragrafin 1, fjalët “**mbikëqyrjen e brendshme**” zëvendësohen me fjalët “**kontrollin e brendshëm**”;
11. Në nenin 13, Kontrolli i brendshëm, në paragrafin 2, fjalët “**anëtar i bordit**” zëvendësohen me fjalët “**anëtar i këshillit**”;
12. Në nenin 16, Arkivimi i dokumentacionit, në paragrafin 4, fjala “**premise**” zëvendësohet me fjalën “**ambienteve**”;
13. Pas nenit 16, shtohet neni 17, me këtë përmbajtje:

“Neni 17
Dispozitë kalimtare

“Shoqëria administruese për SIK që ka nën administrim, detyrohet të përshtatet me dispozitat e kësaj rregulloreje jo më vonë se 6 muaj nga hyrja e saj në fuqi”.

14. Në të gjithë rregulloren numërtimi i neneve ndryshon.